



PRILMARR ME

ACCEPTED ON

PRILMARR ME

05.06.2024

021248



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 04.06.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), të nenit 27 par 27.2, lidhur me paragrafin 1 të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.10/03 Prill 2019), Rregullores QRK-nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 34 dhe 35 dhe Statutit të Komunës së Malishevës, nr.02/441, dt.14.05.2023,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.05.2024 merr këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK TË PRONAVE TË ISH NDËRMARRJES OPB "MIRUSHA" NËN MENAGJIMIN E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, SI NË VIJIM

1. Miratohet, kërkesa e kryetarit të komunës së Malishevës, nr.01/511, dt.26.04.2024, për shpalljen zonë me interes publik, për komunën e Malishevës dhe fillimin e procedurës për bartjen e pronësisë së pronës së menagjuar nga Institucionet Qendrore-Agjencioni Kosovar i Privatizimit.
2. Shpallet zonë me interes publik, pjesët e njësive kadastrale si më poshtë:
 - 2.1- Pjesa e njësisë kadastrale me numër P-72310047-00492-1, me sipërfaqe prej 4081 m² në pronësi të ish-Ndërmarrjes OPB " Mirusha " tani nën menagjimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
 - 2.2-Pjesa e njësisë kadastrale me numër P-72310047-00890-1, me sipërfaqe prej 1558 m², në pronësi të ish Ndërmarrjes OPB " Mirusha " tani nën menagjimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
 - 2.3 Pjesa e njësisë kadastrale me numër P-72310047-00507-1, me sipërfaqe prej 2404 m² në pronësi të ish Ndërmarrjes OPB " Mirusha" tani nën menagjimin e Agjencis Kosovare të Privatizimit,

2.4 Pjesa e njësisë kadastrale me numër P-72310047-00501-28, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2528 m² në pronësi të ish Ndërmarrjes OPB “ Mirusha “ tani nën menagjimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

3. Shpallja e njësive kadastrale të cekura sipas nenit 2 të këtij vendimi, bëhet me qëllim të ligjshëm publik, ngase në këto pjesë janë të vendosura institucionet komunale, stacioni i autobusëve, objekte tjera publike dhe me qëllim të zgjerimit të rrugëve publike në Qytetin e Malishevës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën Kryetari i Komunës, përmes drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Drejtorisë për Pronë.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa e kryetarit të komunës, kërkesa e drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër, certifikatat e pronësisë, kopjet e planit të njësive kadastrale të cilat me këtë vendim janë shpallur zona me interes të përgjithshëm publik.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

-U vendos nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, me datë, 30.05.2024.-

Vendimi ju dërgohet:

- 1.MAPL-së,
- 2.Drejtorive të KK-së
- 3.Arkivit të Komunës

Kryetari i Kuvendit
Argjend Thaçi

